

Vlerësimi i Ndikimit Ekonomik (VNE) i Reformave Strukturore në Kosovë

Divizioni i Politikave Makroekonomike
Ministria e Financave
Kosovë

Përmbajtja:

- Mjeti(et) aktuale të parashikimit që përdoren në departament dhe nevoja për një qasje alternative
- Pasqyrë e shkurtër e CGE-së (së sapo miratuar)
- Vlerësimi i Ndikimit Ekonomik të Katër Masave të Reformës Strukturore:
 - (i) Krijimi dhe funksionimi i Gjykatës Komerciale (ekonomike);
 - (ii) Ulja e ekonomisë joformale;
 - (iii) Ulja e konsumit të energjisë përmes masave të efijencës së energjisë;
 - (iv) Rritja e punësimit si rezultat i trajnimit të synuar të të papunëve;
- Vërejtje përmbyllëse: argumentet ‘për’ dhe ‘kundër’ përdorimit të CGE-së në divizionin tonë

Modeli kryesor i përdorur në MF të Kosovës

- Modeli i Projektimit Makro-Fiskal të Kosovës (MPMK) është zhvilluar në vitin 2006;
- Është një model krejtësisht Kejnezian për sa kohë që BPV përcaktohet nga kërkesa, e cila varet nga ajo se sa para 'injektohen' në ekonomi përmes eksporteve, shpenzimeve të qeverisë dhe diasporës, se si këto injeksione shumëfishohen me prirjen e familjeve për të shpenzuar, dhe sa ka 'rrjedhje' në tatime dhe importe.
- Konsumi privat dhe investimet private parashikohen me ekuacione të thjeshta të sjelljes, ndërsa shumë ndryshore të tjera thjesht parashikohet të rriten me ritme mesatare historike. Konsumi dhe investimet qeveritare përcaktohen sipas planeve të qeverisë. Shumë prej ndryshoreve lidhen nga identitetet e kontabilitetit.
- Detyra kryesore e Divizionit të Politikave Makroekonomike është të projektojë trendin e të hyrave nga tatimet në një horizont kohor trevjeçar dhe të vlerësojë ndikimin e politikave/ tronditjeve të ndryshme në performancën e të hyrave dhe treguesve të tjerë fiskalë.

Pse ka nevojë për një metodologji alternative?

- Vlerësimi i ndikimit ekonomik të Reformave Strukturore është kërkesë e Komisionit Evropian kur përgatitet Programi i Reformës Ekonomike (nga viti i kaluar);
- Para se të kishte një kërkesë të tillë, Ministria e Financave e bënte vetëm kostimin e masave të reformës strukturore dhe siguronte që të gjitha masat e RS-ve të PRE-se të ishin të buxhetuara;
- Mjeti aktual (MPMK) nuk mund të mundësonte bërjen e vlerësimit të ndikimit ekonomik të reformave strukturore;
- Prandaj, zyra e BE-së sigurojë asistencë teknike me qëllim të zhvillimit të një instrumenti të ri që do të mundësonte një vlerësim të tillë;

Vështrim i shkurtër e modelit CGE

- Modeli CGE ka një nivel specifik të përmbledhjes në të gjithë sektorët e ekonomisë së Kosovës (përfshirë 20 sektorë prodhues). Me pak fjalë, modeli është një specifikim numerik i marrëdhënieve të kërkesës dhe prodhimit, marrëdhënieve të ndërsjella mes tyre, dhe zgjidhet njëkohësisht për çmimet në të gjitha tregjet;
- Një vëmendje specifike u është kushtuar sistemeve të të hyrave të qeverisë së Kosovës. Qeveria mbledh tatime direkte mbi të ardhurat e faktorëve, si dhe përqindjet e qirave të kapitalit nga NSH-të. Qeveria po ashtu mbledh tatime indirekte për shpenzimet e brendshme të konsumit të ndërmjetëm dhe përfundimtar dhe për importet. Në fund, qeveria mbledh taksa dhe gjopa nga familjet. Shpenzimet e konsumit, investimeve dhe transferimet e qeverisë jepen në mënyrë ekzogjene;
- Marrëdhënia me pjesën tjetër të botës përcaktohet nga importet dhe eksportet e secilit mall, si dhe të ardhurat neto dhe transferimet ekzogjene për qeverinë dhe/ose familjet. Kursi nominal efektiv i këmbimit është fiks, me kursin real të këmbimit që lëviz për të ekuilibruar bilancin e jashtëm të llogarisë rrjedhëse;

Vështrim i shkurtër e modelit CGE

- Ndërtimi i modelit Multisektorial (CGE) përbëhet nga dy hapa të veçantë:

Së pari, mbledhja e një baze të dhënave të qëndrueshme që lidh kërkesën dhe ofertën e mallrave, të ardhurat e faktorëve, transferimet dhe shpenzimet, dhe kursimet dhe investimet mbledhet në një kornizë unifikuese, **Matrica e Kontabilitetit Social (SAM)**.

Së dyti, bëhet specifikimi teorik (bazuar në parimet e avancuara të optimizimit mikroekonomik) i modelit, programimi në gjuhën e modelit kompjuterik GAMS, dhe parametrimi i modelit duke lidhur kodin GAMS me SAM;

- Modeli CGE është kalibruar në mënyrë që të gjenerojë rezultate fiskale dhe makroekonomike për 2017-2022 kryesisht në përputhje me vlerat aktuale/parashikimet e modelit makroekonomik të MF (MPMK);
- Efektet e masave të RS-ve në ekonomi dhe në treguesit kryesorë të buxhetit konsiderohen si potenciale zhvillimore në rritje (*skenari optimist*);

Masa 1 e RS-së: Themelimi dhe funksionimi i Gjykatës Komerciale - **Ulja e primeve të rrezikut kapital**

- Ky skenar i parë supozon se primi i rrezikut në ekonominë e Kosovës është zvogëluar me 5% krahasuar me skenarin bazë.
 - Ne presim që kjo masë të ndikojë në sektorë realë, fiskalë dhe të energjisë në mënyra të ndryshme
- **Efektet kumulative afatmesme të një uljeje të primeve të rrezikut në rritjen e BPV-së është 2.1% nga 2019 në 2022**
 - Akumulimi i përshpejtuar i kapitalit dhe nivelet më të ulëta të qirasë së kapitalit u sjellin përfitime sektorëve që kërkojnë shumë kapital dhe çojnë në ulje të çmimeve relative të mallrave që kërkojnë shumë kapital. Pa reagim të ofertës së fuqisë punëtore, pagat e punëtorëve do të vazhdojnë të rriten me shpejtësi.
- **Nga akumulimi i madh i kapitalit përfiton sektori që kërkon shumë kapital** - vlera e shtuar në sektorët që kërkojnë më shumë kapital rritet relativisht më shumë se në sektorët e tjerë që kërkojnë më shumë fuqi punëtore - në veçanti, ne presim të shohim një rënie të ndjeshme në sektorin e Hoteleve dhe Restoranteve. Ky sektor është shumë i rëndësishëm për eksportin e shërbimeve dhe ka hapësirë më të kufizuar për rritjen e çmimeve të produktit, se sa sektorët të orientuar më shumë drejt tregut të brendshëm.
- **Akumulimi i madh i kapitalit rezulton në konsum më të madh dhe mirëqenie për të gjithë, por me një rritje të pabarazisë.** Nga të ardhurat më të larta të kapitalit për shkak të akumulimit do të përfitojnë më shumë pronarët ekzistues të kapitalit dhe norma më të larta kursimi se sa ato familje që varen më shumë nga të ardhurat e fuqisë punës.

Masa 2 e RS-së: Ulja e Ekonomisë Joformale - Rritja e të hyrave nga tatimet direkte

- Kjo supozon një rritje e të hyrave nga tatimet direkte si rezultat i përpjekjeve të rritura të inspektimit.
 - Më konkretisht, skenari supozon një rritje graduale të normave efektive të tatimeve direkte gjatë viteve 2021-2023 nga 7.9% në 10% për të gjitha të ardhurat e fuqisë punëtore (TAP) dhe nga 3.2% në 5% për të ardhurat kapitale (TAK dhe tatime në pasurinë e paluajtshme).
- Simulimet për këtë skenar tregojnë se një rregullim i bazuar në të hyra në Kosovë mund të çojë në një shtim të rritjes së BPV-së.
 - Rritja e BPV-së reale rritet me një shumë kumulative prej 0.2% ndërmjet viteve 2020 dhe 2023
 - nxitur nga kursimet më të mëdha të qeverisë (1.8%)
 - investimet (9%).
 - Ky rezultat është intuitiv, pasi rritja e tatimeve i zhvendos të ardhurat dhe konsumin privat në kursime të qeverisë
- Suficiti i buxhetit operacional të qeverisë përmirësohet, duke reflektuar të hyra më të larta nga tatimet dhe ulje të konsumit të qeverisë
- Nga akumulimi më i madh i kapitalit përfitojnë relativisht më shumë sektorët që kërkojnë më shumë kapital, duke çuar në çmime relative më të ulëta për kapitalin dhe paga më të larta
- Rritja e normave të tatimeve direkte dhe rritja e kursimeve të qeverisë kanë implikime pozitive në shpërndarje.

Masa 3 e RS-së: Ulja e konsumit të energjisë përmes masave të efijencës së energjisë - **Zvogëlimi i humbjeve të energjisë dhe kërkesat për subvencione**

- Analiza simulon një eliminim të subvencioneve të energjisë nga niveli aktual prej 3.5% të BPV-së përmes rregullimit efektiv të tarifave
- Eliminimi i subvencioneve të energjisë në Kosovë do të shtojë rritjen e BPV-së në çmimet e tregut me 0.2%
- Kursimet më të larta të qeverisë nga ulja e subvencioneve kompensohen pak nga një rritje e konsumit nominal të qeverisë.
- Analiza e ndikimit të vlerës reale të shtuar sipas sektorit tregon se minierat, prodhimi dhe ndërtimi përfitojnë nga aktiviteti më i madh i investimeve
- Çmimet më të larta të energjisë po dëmtojnë më shumë familjet me të ardhura më të ulëta sesa familjet me të ardhura më të larta

Masa 4 e RS-së: Rritja e punësimit për shkak të trajnimit të fokusuar për të papunët.

- Në skenarin e katërt eksplorohet ndikimi i rritjes së punësimit të fuqisë punëtore për të dhjetën e familjeve 1-5 me 1.5% në vit.
- BPV-ja reale o zgjerohet me 0.4% mbi nivelin bazë
- Me rritjen e punësimit, shumica e sektorëve do të zgjerohen, ku sektorët që kërkojnë më shumë punëtorë do të zgjerohen më shumë mbi vlerën bazë.
- Përpjekja e synuar për punësim çon në të ardhura më të larta dhe rritje të konsumit për një të dhjetën më të ulët mbi vlerën bazë.

Vërejtjet përmbyllëse

- Qasja CGE na mundëson të shohim më mirë ndikimin e reformës strukturore në ekonomi dhe në zërat buxhetorë - megjithatë zbatimi i kësaj qasjeje kufizohet nga:
 - kapacitetet e burimeve njerëzore (lëvizje e madhe e stafit);
 - kufizimet e të dhënave (në ndërtimin e SAM të veçantë për Kosovën u përdorën koeficientët e IO nga Shqipëria);
 - nuk kuptohet mirë nga publiku dhe politikëbërësit;
 - Ndonjëherë modele ose qasje më të thjeshta janë më të dobishme;

Aneksi:

	Ndikimi, Ndryshimi nga vlera bazë			
	Ndikimi (Gjykata Komerçiale)	Ndikimi (Ekonomia joformale)	Ndikimi (Eficienca e Energjisë)	Ndikimi (rritja e punësimit)
Një e dhjeta 1	2.7%	-1.4%	-3.0%	0.1%
Një e dhjeta 2	1.4%	-0.6%	-3.4%	0.5%
Një e dhjeta 3	1.9%	-0.8%	-3.0%	0.8%
Një e dhjeta 4	1.2%	-1.1%	-3.5%	0.7%
Një e dhjeta 5	1.8%	-1.2%	-3.3%	0.8%
Një e dhjeta 6	1.8%	-1.5%	-3.7%	0.9%
Një e dhjeta 7	2.5%	-1.4%	-3.2%	-0.3%
Një e dhjeta 8	2.8%	-1.5%	-3.0%	-0.4%
Një e dhjeta 9	3.3%	-1.4%	-3.1%	-0.2%
Një e dhjeta 10	3.2%	-1.4%	-3.1%	-0.1%
Gini	1.0%	-0.3%	0.4%	-0.5%